



**ÇE DO
DITË -
MËSIM
I RI
SHPRESË
E RE!**



**EDHE KUR JEMI
NË TRAJTIM
SHËNDETËSOR
MËSOJME PËR
JETËN**



PËRKRAHJE PËR NXËNËSIT TË CILËT JANË NË TRAJTIM SHËNDETËSOR

Kur një fëmijë përballlet me një sëmundje kronike që kërkon vizita dhe trajtime të shpeshta në spital, jeta e përditshme bëhet një sfidë e madhe — si për të, ashtu edhe për prindërit dhe mësimmshënësit.

Ditët e gjata në spital, lodhja fizike dhe shqetësimet për shëndetin shpesh e ndërpresin vazhdimësinë e mësimit.

Për këta nxënës, është veçanërisht e rëndësishme të ruhet ndjenja e "normalitetit" dhe e stabilitetit. Një orar i qëndrueshëm, kontakti me mësuesit dhe shokët e klasës, si dhe ndjenja se ende janë pjesë e shkollës, mund të kontribuojnë shumë në ekuilibrin e tyre emocional dhe në motivim.

Megjithatë, për shkak të kufizimeve shëndetësore, ndjekja e rregullt e mësimit shpesh është e pamundur. Në raste të tilla, mësimi online përfaqëson një mbështetje dhe zgjidhje të vërtetë.



PËRPARËSITË E MËSIMIT ONLINE

Orët online kanë përfitime të rëndësishme për fëmijët me sëmundje kronike:

- ✓ Të përfshihen në mësim nga spitali, nga shtëpia ose nga një qendër kujdesi;
- ✓ Të përparojnë me ritmin e tyre – më shpejt kur ndihen më mirë, më ngadalë kur kanë ditë më të vështira;
- ✓ Të qëndrojnë në kontakt me mësimdhënësit dhe shokët e klasës përmes aktiviteteve interaktive, videove, lojërave dhe bisedave.

Komunikimi i rregullt ndërmjet mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve është kryesor. Ajo ndihmon që mësimi të përshtatet me gjendjen shëndetësore, por edhe të mbahet motivimi dhe vetëbesimi i nxënësit.

Mësimet online shpesh tregohen si më shumë se një zgjidhje arsimore – ato mund të ndihmojnë fëmijën të ndihet i përfshirë, i kuptuar dhe i mbështetur. Përkushtimi i përbashkët i mësimdhënësve dhe prindërve krijon kushte që nxënësi të vazhdojë të mësojë, të zhvillohet dhe të qëndrojë në kontakt me shkollën e tij, madje edhe gjatë periudhave më të vështira.



1

Përshtatje dhe mësim sipas ritmit individual

Nxënësit kanë mundësinë të mësojnë në ritmin dhe orarin e tyre, gjë që është veçanërisht e përshtatshme për ata me shëndet të ndryshueshëm, trajtime spitalore ose vizita të rregullta mjekësore. Kjo i lejon ata të fokusohen në shëndetin e tyre pa ndërprerë procesin e të nxënës.

2

Shëndeti dhe siguria

Mësimi i rregullt në prani fizike zvogëlon rreziqet që lidhen me shkollat tradicionale, duke përfshirë ekspozimin ndaj viruseve dhe përqeshje nga bashkëmoshatarët që nuk e kuptojnë gjendjen e fëmijës.

3

Vazhdimësi në arsim

Orët online mundësojnë që nxënësit të vazhdojnë procesin arsimor edhe gjatë trajtimit në shtëpi ose në spital. Hulumtimet tregojnë se ata që e vazhdojnë edukimin gjatë trajtimit mund të arrijnë sukses të njëjtë ose më të lartë se bashkëmoshatarët e tyre.

4

Reduktimi i stresit dhe ankthit

Një mjedis mësimi i përshtatshëm redukton stresin dhe ankthin, pasi nxënësit mund të punojnë kur ndihen mirë, gjë që shpie në nota më të mira.

5

Zhvillimi i aftësive

Mësimi online ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësi kryesore, si organizimi i kohës dhe të nxënës të pavarur, që ka rëndësi të veçantë për ata me sëmundje kronike.

SFIDAT DHE MËNYRAT PËR TEJKALIMIN E TYRE

Menaxhimi i kohës

Disa nxënës kanë vështirësi në organizimin e një plani ditor të të nxënës jashtë shkollës, ku orari dhe njësitë tematike janë të strukturuar në mënyrë të rregullt.

Zgjidhje:

Krijoni një rutinë të strukturuar mësimi dhe vendosni qëllime të qarta dhe të realizueshme.

Izolimi social

Nxënësit mund të vazhdojnë të ndihen të izoluar.

Zgjidhje:

Kur është e mundur, përfshini nxënësit në mësim në largësi/distancë në përputhje me orarin e klasës dhe organizoni aktivitete shpesh për të mbajtur kontaktet sociale.



DISA KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT:

1. Krijoni një ndjenjë përkatësie. Përfshini rregullisht nxënësin në aktivitetet, në pjesëmarrjen online në orë dhe në projektet grupore. Është e rëndësishme që nxënësi të ndjejë se vazhdon të jetë pjesë e klasës.
2. Komunikoni hapur dhe me empati. Pyetni se si ndjehet nxënësi, jo vetëm se si po përparon në mësim. Mbështetja emocionale shpesh është më e rëndësishme se leksioni i mësimi.
3. Përshtatni qëllimet e programit mësimor dhe rezultatet e të nxënit sipas gjendjes shëndetësore të nxënësit.
4. Bashkëpunoni me prindërit. Kuptimi i gjendjes shëndetësore të nxënësit ndihmon në planifikimin dhe realizimin më të mirë të mësimi.
5. Komunikimi i përbashkët krijon siguri për fëmijën. Festoni çdo sukses.

Edhe përparimi më i vogël është një fitore e madhe! Vlerësimi pozitiv rrit motivimin dhe vetëbesimin.

*** Mbani mend se nuk ka rëndësi sa shpejt përparon nxënësi, por është e rëndësishme të mos ndalet.

1. Pyesni fëmijën së pari: "Si je sot?"
2. Përshtatni qëllimet e programit mësimor dhe rezultatet e të nxënit sipas gjendjes shëndetësore të nxënësit.
3. Ofroni përmbledhje të shkurtëra të leksioneve ose materialeve për të lehtësuar kuptimin.
4. Gëzojuni çdo hapi të përparimit, edhe atij më të voglit.



Një kujtesë e vogël për të gjithë ne - Mbështetja është më e fuqishme kur vjen nga të gjitha anët, kur besojmë së bashku në fuqinë e fëmijës.

SI MUND TË NDIHMOJMË TË GJITHË SË BASHKU?

Bashkëmoshatarë

1. Tregoni se nxënësi është pjesë më e rëndësishme e klasës.
2. Dërgoni një mesazh: Të presim të kthehesh!
3. Përfshini atë në aktivitete grupore dhe takime online.
4. Bëhuni miq.

Prindër

1. Mbani rutinën dhe ndjenjën e stabilitetit sa më shumë të jetë e mundur.
2. Kujtojini fëmijës se të mësuarit mund të jetë mbështetje, jo detyrim.
3. Bashkëpunoni rregullisht me mësimdhënësit që të përshtatet ritmi i të nxënit.

Përpiluan:



Republika e Maqedonisë së Veriut
**Ministria e Arsimit
dhe Shkencës**



Министерство за образование и наука / Министерство за образование и наука
Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Република Македонија
Ministry of Education and Science - Bureau for Development of Education

